



A.nr.771/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.771/2026, të datës 10.07.2026, të parashtruar nga ankuesja L.H nga Lipjani, kundër organit të punësimit/Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.07.2026, nxjerrë, këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.771/2026, e datës 10.07.2026, e parashtruar nga ankuesja L.H.

A r s y e t i m

Ankuesja L.H (*tutje referuar ankuesja*) më datë 10.07.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01-111/01-31307, të datës 09.07.2026, për refuzimin e aplikacionit, lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00019850 për Grupin e Inxhinierisë së Ndërtimit pozita *Zyrtar për Leje Ndërtimore* të shpallur nga Komuna Klinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 13.07.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 14.07.2026, i ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të çështjes ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se Komuna e Lipjanit, më datë 04.06.2026, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00019850 për Grupin e Inxhinierisë së Ndërtimit pozita *Zyrtar për Leje Ndërtimore*, me afat aplikimi nga data 05.06.2026 deri më datë 04.07.2026.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, mirëpo, sipas Vendimit me Nr. 01-111/01-31307, të datës 09.07.2026 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit, të njëjtës i është refuzuar aplikacioni, me arsyetimin se nuk posedon kontratën

apo vërtetimin e përvojës së punës të lëshuar nga institucioni përkatës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton Vendimin me Nr. 01-111/01-31307, të datës 09.07.2026 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit, duke pretenduar se në aplikacion ka bashkangjitur dëshminë e përvojës së punës prej 2.5 vitesh dhe e kam dëshmuar sipas pasqyrës zyrtare të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës e cila pasqyron periudhat e punësimit dhe pagesën e kontributeve pensionale. Refuzimi i aplikacionit është bërë pa u vërtetuar në tërësi provat që dëshmojnë se i plotëson provat e lëndës. Kërkon që të aprovohet ankesa, të shfuqizohet vendimi për refuzimin e aplikacionit dhe të obligohet Komuna e Lipjanit që të rivlerësoj aplikimin duke marr parasysh të gjitha provat e paraqitura.

Në kuptim të praneushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë gjegjësisht, nenit 39, paragrafi 12 i cili përcakton se: *“12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil parashihet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankueses e parashtruar më datë 10.07.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër vendimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses të datës 10.07.2026, nuk kishte përfunduar procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00019850 për pozitën *Zyrtar për Leje Ndërtimore*, rrjedhë se ankesa e ankueses A.nr.771/2026, e datës 10.07.2026 është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publikë dhe nenin 17 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin se hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.771/2026 nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda;A.nr.771/2026, datë 21/07/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses L.H;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.